



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:038580
Datë: 18.07.2024
Numri i dokumentit: 05954723

K.Dh.Sh II.nr.1041/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija-Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Ramush Bardiqi anëtare të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Diessel S.p.A me seli në Breganze, shteti i Italisë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Florin Lata nga Prishtina, kundër të paditurit “MEGKOS TRANS” SH.P.K., me NUI: 811908518, me seli në rrugën “Vasil Andoni” nr.17, Prishtinë, për shkak të shkeljes së markës tregtare, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Ekonomike, KE.nr.124/23, të datës 04.04.2024, me datë 11.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses Diessel S.p.A me seli në Breganze, shteti i Italisë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Ekonomike, KE.nr. 124/23, të datës 04.04.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e Dhomës së shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka vendosur si në vijim; APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Diessel S.p.A dhe VËRTETOHET se i padituri “MEGKOS TRANS” SH.P.K., përmes importimit të 88 palë pantollona për të rritur me datë 20.01.2023, ka shkelur markën tregtare të paditësit “DIESEL”

me nr. regjistrimit 16791 dhe markën tregtare “D” me nr. regjistrimit 18471, I NDALOHET të paditurit MEGKOS TRANS” SH.P.K., që në të ardhmën të importojë apo në çfardo forme të tregtojë me mallra që shkelin markat tregtare të paditësit “DIESEL” me nr. regjistrimi 16791 dhe markën tregtare “D” me nr. regjistrimin 18471. OBLIGOHET i padituri që me shpenzimet e tij të shkatërroj të gjitha mallrat si në pikën I të dispozitivit, në afat prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbushjes së detyrueshme. IV. OBLIGOHET i padituri që të mbuloj të gjitha shpenzimet e magazinimit të mallrave si në pikën I të dispozitivit, në afat prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbushjes së detyrueshme V. REFUZOHET si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditësit me të cilin ka kërkuar që të detyrohet i padituri MEGKOS SH.P.K., që në emër të shkeljës së markës tregtare t’i paguaj paditësit ndëshkimin në shumën prej 5,000.00 EUR. VI. DETYROHET i padituri që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 798.00 € (shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro), në afat prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ta aprovoje në tërësi si të bazuar ankesën e paditësit, të ndryshohet pika V e aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës , Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KE .nr.124/23 i datës 04.04.2024, ashtu qe te aprovohet kërkesa e paditësit Diessel S.p.A, me seli ne Itali, sipas pikës V. Dhe te obligohet i padituri Megkos Trans sh.p.k që paditësit t’ia paguaj ndëshkimin ne shumën prej 5.000.00 euro në afat prej 7 ditësh.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqit i padituri.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale e ka shqyrtuar ankesën e paditëses Diessel S.p.A dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës secilën veç e veç e edhe lidhshmërinë e tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti;
Ankesa është e pabazuar.

Gjykata e Dhomës së Shkallës së Parë pas administrimit të provave dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqës ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit Gjykata e shkallës e parë e ka aprovuar

pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, duke ja ndaluar të paditurit MEGKOS TRANS” SH.P.K., që në të ardhmën të importojë apo në çfarëdo forme të tregtojë me mallra që shkelin markat tregtare të paditësit “DIESEL” me nr. regjistrimi 16791 dhe markën tregtare “D” me nr. regjistrimin 18471, po ashtu ka obliguar të paditurin që me shpenzimet e tij të shkatërroj të gjitha mallrat si në pikën I të dispozitivit, në afat prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbushjes së detyrueshme. Ka obliguar që i padituri të mbuloj të gjitha shpenzimet e magazinimit të mallrave si në pikën I të dispozitivit, në afat prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbushjes së detyrueshme. Dhe i padituri t’ia paguaj paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 798.00 € (shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro), në afat prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Ndërsa e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit me të cilin ka kërkuar që të detyrohet i padituri MEGKOS SH.P.K., që në emër të shkeljes së markës tregtare t’i paguaj paditësit ndëshkimin në shumën prej 5,000.00 EUR. Me arsyetim se kërkesëpadia e paditësit është e pjesërishtë e bazuar, kjo për faktin se nga njoftimi i Doganës së Kosovës 88 palë pantallona të cilat kanë të vendosur markën tregtare verbale të paditësit “Diesel” dhe marën figurative “D”, ndërsa nga konfirmimi mbi origjinalitetin e lëshuar zyra ligjore e paditësit në shtetin e Italisë rezulton se mallrat në fjalë, nuk janë të prodhuara nga paditësi apo ndonjë degë e autorizuar nga ky i fundit, ka shtuar se në kuptim të nenit 75 të LMT-së, e paditura me importimin e mallrave jo origjinale të cilat përmbajnë markën tregtare të paditësit, ka shkelur të drejtat e palës paditëse që burojnë nga markat tregtare “Diesel” dhe markat figurative “D”. Po ashtu ka shtuar se sa i përket pjesës refuzuese lidhur me shqiptimin e ndëshkimit në favor të palës paditëse shumën prej 5,000.00euro për faktin se në rastin konkret, shqiptimi i masës ndëshkuese nga neni 75 par 4 i LMT-së, me rastin e vërtetimit të shkeljes së markës tregtare parashihet si mundësi dhe jo obligim për gjykatën, e në këtë drejtim gjykata ka vlerësuar se shqiptimi i kësaj mase nuk është propozionale me natyrën e shkeljes për faktin se mallrat përmes të cilave i padituri ka shkelur markën tregtare të paditësit, veçse janë ndaluar nga Dogana e Kosovës dhe nuk janë futur në qarkullim tregtare të paditësit, veçse janë ndaluar nga Dogana e Kosovës dhe nuk janë futur në qarkullim tregtar, andaj dëmi ndaj paditësit është parandaluar përmes këtij veprimi, rrejdhëmisht konstatimi i ekzistimit të shkeljes së markës, ndalimi i shkeljes për të ardhëmen si dhe shkatërrimi i mallrave të importuara, paraqesin masa të mjaftueshme në raport me seriozitetin e shkeljes së markës tregtare.

Dhoma e Shkallës së Dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Dhoma e Shkallës së Dytë mbështet në tërësi konstatimet dhe shpjegimet lidhur me faktet dhe rrethanat vendimtare të cilat kanë prurë që të mirët një aktgjykim pjesërisht aprovues, e që në mënyrë të thukët i ka dhënë Gjykata e Dhomës së Shkallës së Parë. Dhoma e Shkallës së Dytë po ashtu konstaton se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sepse gjykata ka administruar gjitha provat e propozuara, dhe i ka vlerësuar se cilën veç e veç e edhe varshmërin e tyre dhe ka gjet se çështja faktike është vërtetuar drejtë dhe në bazë të kësaj çështje faktike drejtë janë aplikuar dispozitat ligjore, të cekura më hollësisht në aktgjykimin e kundërshtuar.

Kështu që Gjykata e Shkallës së Parë me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale ka marrë aktgjykimin me të cilën e ka aprovuar pjesërisht padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, e cila ka kërkuar që të vërtetohet se e paditura ka shkelur markën tregtare të paditësit. Edhe Dhoma e Shkallës së Dytë i mbështet konstatimet dhe vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se në këtë çështje civile-juridike paditësi ka të regjistruar pranë Agjencisë së Pronësisë Industriale markën tregtare fjalë “DIESEL” dhe është bartës i të drejtës së markës tregtare për produktet dhe shërbimet nga Klasa 3, 9, 11, 14, 18, 19, 20, 21, 24, 25, 29, 30, 32 dhe 33, dhe atë me vlefshmëri kohore deri më 31.10.2028. Nuk është kontestuese se i padituri, ka importuar mallrat kontestuese prej 88 palë pantollona të cilat kanë të vendosur markën tregtare verbale të paditësit “Diesel” dhe markën figurative “D”. Ndërsa, nga konfirmimi mbi origjinalitetin e lëshuar zyra ligjore e paditësit në shtetin e Italisë rezulton se mallrat në fjalë, nuk janë të prodhuara nga paditësi apo ndonjë degë e autorizuar nga ky i fundit. Pra fakti se shenja që është përdorur në produktet e të paditurës janë identike me markën tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit dhe të cilat shkaktojnë konfuzion në publik edhe secili konsumator do të krijojë bindje se bëhet fjalë për produktet e paditësit. Andaj, në bazë të gjithë këtyre provave të administruara të vërteta dhe të pakontestueshme gjykata e shkallës së parë ka vendosur që ta aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit. Një konstatim të tillë i gjykatës së

shkallës së parë është e pranueshme edhe për Dhomën e Shkallës së Dytë. Andaj me Ligjin Nr.08/L-075 Për Markën Tregtare gjegjësisht neni 9 par 1 dhe par 2 parashihet se “*Marka e rregjistruar është e drejtë ekskluzive e pronarit të saj. Pronari i markës tregtare të rregjistruar ka të drejtë të ndalojë të gjitha palët e treta që nuk kanë pëlqimin e tij që ta përdorin atë gjatë afarizimit tregtarë, lidhur me mallra apo shërbime, çfarëdo shenje që; 2.1 është indentike me markën tregtare, për mallra ose shërbime që janë identike me ato për të cilat është rregjistruar markën tregtare*”. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund të ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjën identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Andaj, duke u bazuar edhe me nenin 75 të LMT-së me të cilën parashihet se “*1. Pronari i markës tregtare mund të parashtron padi kundër çdo personi që ka shkelur markën tregtare duke kryer, pa autorizim, ndonjë nga veprimet e përmendura në nenin 9,10 ose 12 paragrafi 1 të këtij ligji, duke kërkuar 1.1 konstatimin e shkeljes së të drejtëve të markës;1.2 distacimi nga veprimi i shkeljes, ndalimi i shkeljes së të drejtëve dhe ndalimi i vazhdimit të shkeljeve të tilla dhe të ngjashme të të drejtëve në të ardhmen*” e që në rastin konkret e paditura me importimin e mallrave jo origjinal të cilat përmbajnë markën tregtare të paditësit ka shkelur markën tregtare të paditësit “Diesel” dhe markën figurative “D”, andaj kolegji i kësaj gjykate vlerëson se aktgjykimi i ankimuar është i drejtë.

Në ankesën e paditësit pretendohet se Gjykata e Shkallës së Parë në pikën V të dipozitivit e ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë me të cilën paditësi ka kërkuar shqiptimin e ndëshkimit në lartësi prej 5.000.00 euro ndaj të paditurës në favor të pronarit të markës tregtarë, lidhurë me këtë pretendim gjykata e shkallës së parë ka dhënë mjaftushëm arsytimi në aktgjykimin e ankimuar me të cilën e mbështet edhe kjo gjykatë ngase sipas nenit 75 paragrafi 4 të LMT-së shihet se në rast të vërtetimit të shkeljes së markës tregtare parashihet si mundësi dhe jo obligim për gjykatën, kështu edhe kjo gjykatë vlerëson se me shqiptimin e kësaj mase nuk është propocionale me natyrën e shkeljes për faktin se mallrat përmes të cilave i padituri ka shkelur markën tregtare të paditësit , veç se janë të ndaluar nga Dogana e Kosovës dhe nuk janë futu në qarkullim tregtare, andaj demt ndaj paditësit është parandaluar për mes këtij veprimi, andaj një pretendim të tillë kjo gjykatë e refuzoj si të pa bazuar.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten dhe se

aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh II.nr.1041/24 dt.11.07.2024

Krytarja e kolegjit

Franciska Zhitija-Ymeri